



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.258, datë 11.10.2022

PËR
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zonja Irena Çunoti, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, të caktohet përkohësisht si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
2. Zonja Irena Çunoti do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë nga data 20.10.2022 - 19.01.2023.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zonja Irena Çunoti do të paguhet me pagën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
4. Të njoftohen për këtë vendim zonja Irena Çunoti, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 11.10.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirrela Bogdani